



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



22.12.2021
Prishtinë

Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3.6, lidhur me nenin 47 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nxjerr:

VENDIM

1. **Miratohet** Rregullorja Nr. 14/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa kjo Rregullore do të hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit të saj nga Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

T'i dërgohet;

1x Arkivit të ARRU

1x Kryeshefave Ekzekutiv të KRU-ve

1 x Të gjithë zyrtarëve të ARRU



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. prot./Prot. br./ Prot. No.	607
Nr. detyr./Dutys. br./Req. No.	0
Datë/Date/Date	22/12/2021
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	



Në bazë të kompetencave të dhëna me nenin 4 paragrafi 3.6 dhe nenin 47 paragrafi 3, lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit,

Nxjerr:

RREGULLORE NR.14/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.06/2016 PËR NDËRPRERJE NGA SHËRBIMET E UJIT NË KOSOVË

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të ndryshoj dhe plotësoj Rregulloren Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë dhe përcaktimin e dëmit të shkaktuar nga lidhjet e paautorizuara, si dhe rikthimin e humbjeve të shkaktuara nga shfrytëzuesit e shërbimeve të ujit, pa lejen ose autorizimin e ofruesit të shërbimeve.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 **Lidhje e paautorizuar** - nënkupton, lidhja në mes objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura që nuk është kryer nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura dhe në pajtim me ligjin;
 - 1.2 **Konsumatorët komercial me biznese të mëdha (industrial)**- nënkupton bizneset të cilat konsumin mujor të ujit e kanë mbi 300 m³.
 - 1.3 **Konsumatorët komercial me biznese të mesme** - nënkupton bizneset të cilat konsumin mujor të ujit e kanë nga 51 – 300 m³.
 - 1.4 **Konsumatorët komercial me biznese të vogla** - nënkupton bizneset të cilat konsumin mujor të ujit e kanë deri në 50 m³.
 - 1.5 **Rikthim i humbjeve** - nënkupton, sasia e llogaritur e ujit të humbur nga dëmi i shkaktuar si pasojë e shfrytëzimit të paautorizuar të shërbimeve për periudhën një vjeçare;
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në legjislacionin përkatës për rregullimin e shërbimeve të ujit.

Neni 3

Në neni 18 të rregullores bazike, pas paragrafit 2 shtohet nen i ri 18A, me tekstin si në vijim:

Neni 18/A

Shfrytëzimi i paautorizuar i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit

1. Çdo person fizik apo juridik që në mënyrë të paautorizuar merr, përdorë, devijon, shfrytëzon, ose përfiton nga lidhjet ose rilidhjet në rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit, pa lejen ose autorizimin e ofruesit të shërbimeve, me qëllim të rikthimit të humbjeve do të ngarkohet me sasinë e llogaritur të ujit të humbur si pasojë e shfrytëzimit të paautorizuar.
2. Çdo person fizik apo juridik për të cilin vërtetohet se ka keqpërdor shërbimet e ujit të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve në emër të dëmit të shkaktuar dhe me qëllim të rikthimit të humbjeve, do të ngarkoj me sasinë e ujit të humbur, duke u bazuar në përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar në shtojcën 1, të kësaj rregulloreje, të cilët do të faturohen si në vijim:
 - 2.1.Konsumatorët institucional, në sasi prej 9,141 m³;
 - 2.2.Konsumatorët komercial me biznese të mëdha (industrial), në sasi prej 12,780 m³;
 - 2.3.Konsumatorët komercial me biznese të mesme, në sasi prej 2,077 m³;
 - 2.4.Konsumatorët komercial me biznese të vogla, në sasi prej 214 m³;
 - 2.5.Konsumatorët shtëpiak të zonave urbane, në sasi prej 335 m³;
 - 2.6.Konsumatorët shtëpiak të zonave rurale gjysmë-rurale, në sasi prej 343 m³;
 - 2.7.Konsumatorët shtëpiak në apartamente (banim kolektiv), në sasi prej 230 m³.
3. Kategorizimi i konsumatorëve komercial sipas përkufizimeve të cekura në nenin 2, paragrafi 1.2; 1.3; 1.4 bëhet duke marrë për bazë konsumin mujor të tri bizneseve me veprimtari të ngjashme të konsumatorëve të rregullt me ujëmatës.
4. Kushdo që bën shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve përveç që do t'i ndërmerr veprimet të parapara me paragrafin 2 të këtij neni, duhet të paraqet edhe kallëzim penal në prokurorinë kompetente.

Neni 4

Në nenin 31 të paragrafit 2, riformulohet nënparagrafi 2.3.2, me tekstin si në vijim:

- 2.3.2 Këstet mujore që përbëhen nga shuma e mbetur e borxhit të akumuluar e ndarë proporcionalisht në këste për një periudhë që nuk tejkalon tridhjetë e gjashtë (36) muaj dhe shuma e faturuar në muajin përkatës;

Neni 5

Në nenin 31 të paragrafit 4, fshihen në tërësi nënparagrafët 4.3 dhe 4.4.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas pesëmbëdhjetë (15) dite, nga dita e nënshkrimit dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

Datë 22.12.2021



SHTOJCA 1

1. Përlllogaritja e mesatares mujore dhe vjetore e sasisë së konsumit të ujit në m³, për të gjithë shfrytëzuesit e ujit në mënyrë të paautorizuar që ju përkasin kategorive të konsumatorëve të cekura në nenin 18/A paragrafin 2 të kësaj rregullore, është bërë në bazë të 630 mostrave të marra për konsumatorët e kategorive përkatëse, në shtatë (7) zonat të Kosovës, ku ofrojnë shërbime kompanitë rajonale të ujësjellësit.

1. Tabela për paraqitjen e shfrytëzuesve të ujit në mënyrë të paautorizuar që ju përkasin kategorive përkatëse të konsumatorëve.

	Kategoria e konsumatorit	Mesatarja e konsumit mujor në m ³	Mesatarja e konsumit vjetor në m ³
2.1	Konsumatorët institucional	762	9,141
2.2	Konsumatorët komercial me biznese të mëdha (industrial)	1,065	12,780
2.3	Konsumatorët komercial me biznese të mesme	173	2,077
2.4	Konsumatorët komercial me biznese të vogla	18	214
2.5	Konsumatorët shtëpiak të zonave urbane	28	335
2.6	Konsumatorët shtëpiak të zonave rurale gjysmë-rurale	29	343
2.7	Konsumatorët shtëpiak në apartamente (banim kolektiv)	19	230